

# RELACION

## PËR

### **PROJEKTLIGJIN “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË VITIT 2021”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i projektligjit është miratimi i buxhetit faktik të qeverisjes së përgjithshme të vitit 2021.

Objektivi që synohet është plotësimi i kërkesës ligjore (të neneve 62 dhe 63, të ligjit nr.9936 datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, për raportimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2021, të llogarive vjetore për transaksionet financiare të entiteteve të qeverisjes së përgjithshme (qeverisjes qendrore, vendore dhe fondeve speciale të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe të trajtimit të pronave) dhe informimin për arritjen e objektivave, situatën e menaxhimit, të kontrollit të brendshëm financiar dhe auditimit të brendshëm.

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektligj lidhet me prioritetet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë: “Sektor publik i besueshëm, eficient dhe transparent”.

#### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Projektligji synon publikimin e informacionit të plotë mbi performancën makrofiskale dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2021, objektivat e arritur dhe produktet e realizuara nga çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji propozohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 62 dhe 63, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Projektligji ka lidhje me prioritetet e BE-së: “*Rule of law*”.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji përmban 2 nene, nenin 1 “Miratimi i raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit”, përmes së cilit miratohet raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit për vitin 2021, sipas dokumenteve të mëposhtme, që i bashkëlidhen këtij ligji dhe janë pjesë përbërëse të tij:

- a) Pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit, për vitin 2021;
- b) Raporti për zbatimin e buxhetit vjetor 2021, në nivelin e fondeve të miratuara dhe objektivat e realizuar;
- c) Raporti për borxhin publik dhe përbërjen e tij, për vitin 2021;
- ç) Raporti për përdorimin e fondit rezervë dhe të kontingjencës, për vitin 2021;
- d) Raporti për situatën e kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjatë vitit 2021.

Në nenin 2 jepet hyrja në fuqi e projektligjit, 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

## **VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Në hartimin e projektligjit kanë kontribuar strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të njërive të qeverisjes së përgjithshme.

## **VIII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë është institucioni që ngarkohet për zbatimin e projektligjit.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektligji nuk shoqërohet me të ardhura apo shpenzime buxhetore.